



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 82, Datë 03/04/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbështetur në informacionin e përcjellë me e-mail nga përfaqësues të Projektit “Për fuqizimin social dhe ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian” të UNDP, si dhe pas pjesëmarrjes në takimin e datës 17.10.2017, të realizuar me përfaqësues të shoqatave e prindërve romë me stafin mësimor të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi inicioi hetimin ex-officio të çështjes mbi disa problematika të raportuara nga përfaqësuesit e komunitetit rom, lidhur me arsimimin e nxënësve romë pranë kësaj shkolle.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Referuar korrespondencës elektronike ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe drejtuesve të Projektit “Për fuqizimin social dhe ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian” të UNDP-së, si dhe duke iu përmbajtur problematikave të diskutuara në takimin e datës 17.10.2017, të realizuar ndërmjet përfaqësuesve të UNDP-së, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shoqatave romë e prindërve romë, me stafin mësimor të Shkollës 9- vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, rezulton se përfaqësues të komunitetit rom të Nishtullës kanë ngritur një sërë pretendimesh, lidhur me çështjen e arsimimit të nxënësve romë në Shkollën 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, si më poshtë:

- Çështja e transferimit të nxënësve të kësaj shkolle drejt shkollave të tjera, pasi godina aktuale e shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra” do të rikonstruktohet. Problemi i lindur konsiston në faktin, që familjeve të nxënësve romë do t’u duhet të përballen me shpenzime financiare, lidhur me transportin e tyre të përditshëm.
- Pretendime të prindërve romë, për raste dhune të ushtruar ndaj fëmijëve të tyre, në shkollën 9-vjeçare “Isuf Ferra” nga mësuesit dhe bashkëmoshatarët.
- Pretendime për diskriminim dhe neglizhencë të përfshirjes së nxënësve romë në orën e mësimit dhe jashtë saj, nga stafi mësuesor i shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë;
- Pretendime për vënien e mungesave pa arsye, kur fëmijët romë angazhohen në aktivitete kulturore (të ndërmarra ose jo nga vetë shkolla), që kanë çuar në humbjen e vitit shkollor.
- Pretendime për braktisje të shkollës, pas dhunës së ushtruar ndaj nxënësve romë;
- Pretendime për mos përfshirje të prindërve romë në aspekte të ndryshme, lidhur me arsimin e fëmijëve të tyre.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë :

☒ Pas pjesëmarrjes në takimin e datës 17.10.2017, të realizuar me përfaqësues të UNDP-së, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shoqatave e prindërve romë me stafin mësuesor të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet Urdhërit nr. 145, datë 20.10.2017, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin ex-officio të kësaj çështjeje.

☒ Mbështetur në nenin 33, pika 7¹, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, me shkresën nr. 1023/1, datë 24.10.2017, ku kërkohet informacion, lidhur me problematikat e parashtruara nga përfaqësuesit e komunitetit rom.

- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, dërgoi shkresën nr. 153/1, datë 05.10.2017, ku jepen sqarimet përkatëse lidhur me pretendimet prindërve dhe përfaqësuesve të shoqatave të komunitetit rom të Nishtullës.

Sipas shkresës së sipërpërmendur, Komisioneri bëhet me dije lidhur me faktin, se transferimi i nxënësve në një tjetër shkolle, për shkak të riparimit të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, nuk ishte vendosur ende dhe drejtorja e shkollës nuk ishte njoftuar mbi një gjë të tillë. Në këtë kontekst, drejtori i shkollës sqaron faktin, se në momentin e transferimit e në

¹ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe ngaçdo person ose burim tjetër”.

vijim, shpenzimet e transportit të fëmijëve romë dhe jo romë do të merren përsipër për t'u mbuluar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës dhe Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit. I vetmi shpenzim i familjeve romë dhe jo romë do të konsistonte në hapjen e një llogarie bankare, e cila kushton 500 lekë.

Ndër të tjera, në shkresë sqarohet fakti se nuk ka patur raste dhunë të ushtruar nga mësues të kësaj shkolle ndaj nxënësve romë që mësonin pranë saj. Ndërkohë që, ka patur raste sporadike të dhunës që bashkëmoshatarët ushtronin ndaj njëri tjetrit, të cilat janë zgjidhur nga grupi i punës që funksionon pranë kësaj shkolle, ku bëjnë pjesë zv/drejtori i shkollës, psikologjia, mësuesit kujdestarë. Drejtori i shkollës sqaron se këto raste dhune ndërmjet bashkëmoshtarëve, janë raste, kur fëmijët romë dhunojnë ata jo romë dhe jo e kundërta. Lidhur me një rast dhune fizike të pretenduar, se është ushtruar nga ana e mësueses ndaj një nxënësi të klasës së parë, drejtori sqaron se një gjë e tillë ka qenë pretenduar nga një përfaqësues i shoqatës "Amaro Drom", në një takim të zhvilluar në datën 10.10.2017 dhe jo nga prindi i fëmijës. Ky i fundit është shprehur se fëmija i tij nuk është dhunuar, por gjakderdhja nga hundët është një fenomen që fëmija e tij e ka që kur ka lindur dhe jo se e ka dhunuar mësuesja e tij.

Në shkresën nr. 153/1, datë 05.10.2017, Z. L. B., drejtor i shkollës, shprehet gjithashtu se ka patur pretendime nga ana e një prindi rom për t'i kaluar fëmijën e tij, që të mos humbte vitin shkollor, pa e frekuentuar shkollën dhe në kushtet e mungesave të parasyeshme. Ky rast u bë evident gjatë takimit të datës 17.10.2017, ku të gjithë të pranishmit u informuan në lidhje me pretendimet e prindit rom.

☐ Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet Urdhërit nr. 182, datë 15.12.2017, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, inspektorët e Komisionerit u paraqitën për inspektim pranë Shkollës 9-vjeçare "Isuf Ferra", Nishtullë, Durrës. Z. L. B., drejtori i kësaj shkolle i sqaroi inspektorët e Komisionerit mbi çështjet që përbënin objekt inspektimi², si dhe në vijim dërgoi shkresën 107/89, datë 22.12.2017, ku sqaron se për një nga rastet, kur është pretenduar dhunë ndaj një nxënësi rom të klasës së parë, dhuna nuk ka qenë e vërtetë dhe pretendimi nuk ka qenë i prindit të fëmijës, por i një përfaqësuesi të Shoqatës Amaro Drom. Ky fakt është i verifikueshëm, duke u mbështetur në procesverbalin e takimit të kryer me prindin e fëmijës, mësuesen përkatëse dhe psikologun e shkollës, si dhe deklaratën e lëshuar nga prindi i fëmijës.

Lidhur me çështjen e transferimit të të nxënësve të kësaj shkolle në një shkollë tjetër, për efekt të riparimit të godinës së Shkollës 9-vjeçare "Isuf Ferra", Nishtullë, në shkresë sqarohet se mësimi

²Objekti i inspektimit konsistonte: Informacion i hollësishëm mbi rastin e nxënësit rom të klasës së parë, për të cilin pretendohet, se është ushtruar dhunë nga ana e mësueses. Drejtoria e Shkollës të njoftojë edhe prindërit e nxënësit në fjalë, për t'u takuar me inspektorët e Komisionerit; Informacion mbi numrin e nxënësve romë, të cilët nuk kanë kaluar vitin e kaluar mësimor, për shkak të mungesave pa arsye; Informacion mbi numrin e nxënësve të maxhorancës që nuk kanë kaluar vitin e kaluar mësimor, për shkak të mungesave pa arsye; Informacion mbi numrin e nxënësve romë që kanë braktisur shkollën, 3 vitet e fundit; Informacion mbi numrin e nxënësve romë, që kanë mësuar pranë shkollës 9-vjeçare "Isuf Ferra", Nishtullë, përgjatë 3 viteve të fundit; Mbledhja dhe administrimi i informacioneve të tjera, që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

do të vijojë pas pushimeve të vitit të ri, në Shkollën 9-vjeçare MB Shënavlash. Transportin e fëmijëve e ka marrë përsipër Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës dhe Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

☒ Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 136, datë 23.01.2018, dy përfaqësues të stafit mësimor të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, koordinatori lokal e UNDP-së pranë kësaj shkolle, si dhe prindërit e disa nxënësve romë u njoftuan për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë pretendimet e tyre për dhunë ushtruar ndaj fëmijëve të tyre, si dhe për moskalim të vitit shkollor për shkak të mungesave.

Në vijim të shkresës nr. 136, datë 23.01.2018, Drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë njoftoi me e-mail Komisionerin, se në një rast, ku është pretenduar dhunë ndaj një nxënësi të klasës së parë pranë kësaj shkolle, çështja është sqaruar me prindin dhe mësuesen përkatëse. Prindi ka deklaruar se ndaj fëmijës së tij nuk është ushtruar dhunë. Ndërkohë që, një tjetër nxënës, për të cilin është pretenduar se ka humbur vitin shkollor për shkak të mungesave të kryera gjatë vitit shkollor, ai është kthyer në shkollë dhe vazhdon procesin mësimor normalisht. Ndër të tjera, Z. L. B. thekson faktin se është kontaktuar me prindërit e nxënësve romë që janë ftuar për të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe ata janë shprehur se e kanë të pamundur të paraqiten në seancën dëgjimore të Komisionerit dhe se i kanë zgjidhur çështjet e tyre, për të cilat janë dorëzuar procesverbalet përkatëse.

Në vijim të këtij e-maili, në seancë dëgjimore nuk u paraqit asnjë nga palët.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, Komisioneri gjykon se:

I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues të pretenduar në çështjen ex-officio:

Në dy takimet e realizuara, fillimisht në datën 10.10.2017, me përfaqësues të shoqatave romë në Nishtullë, përfaqësues të Projektit “Për fuqizimin social dhe ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian” të UNDP dhe stafin akademik dhe drejtues të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë dhe në vijim në datën 17.10.2017 edhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u evidentuan disa problematika, të cilat u diskutuan me pjesëmarrësit në këto takime dhe përgjithësisht konsistonin në çështjet e mëposhtëme:

- Çështja e transferimit të nxënësve të kësaj shkolle drejt shkollave të tjera, pasi godina aktuale e shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra” do të rikonstruktohet. Problemi i lindur konsiston në faktin, që familjeve të nxënësve romë do t’u duhet të përballen me shpenzime financiare, lidhur me transportin e tyre të përditshëm;

- Pretendime të prindërve romë, për raste dhune të ushtruar ndaj fëmijëve të tyre, në shkollën 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë nga mësuesit dhe bashkëmoshatarët;
- Pretendime për vënien e mungesave pa arsye, kur fëmijët romë angazhohen në aktivitete kulturore (të ndërmarra ose jo nga vetë shkolla), që kanë çuar në humbjen e vitit shkollor;
- Pretendime për diskriminim dhe neglizhencë të përfshirjes së nxënësve romë në orën e mësimi dhe jashtë saj, nga stafi mësimor i shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë;
- Pretendime për braktisje të shkollës, pas dhunës së ushtruar ndaj nxënësve romë;
- Pretendime për mos përfshirje të prindërve romë në aspekte të ndryshme, lidhur me arsimin e fëmijëve të tyre.

Përgjatë procesit të shqyrtimit administrativ të çështjes ex-officio, sikurse edhe mbështetur ne procesverbalin e takimit të datës 17.10.2017, rezultoi se:

- Lidhur me problematikën e parë, të evidentuar gjatë të dy takimeve të realizuara, që ka të bëjë me transferimin e përkohshëm të nxënësve të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, drejt një shkolle tjetër, për shkak të riparimit të godinës së kësaj shkolle, rezultoi se mësimi për nxënësit e kësaj shkolle vijoi pas pushimeve të vitit të ri, në Shkollën 9-vjeçare MB Shënavlash. Transporti i nxënësve është marrë përsipër nga Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës dhe Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, kështu që familjet e komunitetit rom Nishtullë nuk do të përballen me shpenzimet e transportit për fëmijët e tyre. I vetmi shpenzim i familjeve rome dhe jo rome do të konsistonte në hapjen e një llogarie bankare, e cila kushton 500 lekë.
- Lidhur me pretendimet e prindërve romë, për raste dhune të ushtruar ndaj fëmijëve të tyre, në shkollën 9-vjeçare “Isuf Ferra” nga mësuesit dhe bashkëmoshatarët rezultoi se ka patur raste sporadike të dhunës ndërmjet nxënësve të kësaj shkolle, por këto janë raste, kur fëmijët romë dhunojnë ata jo romë dhe jo e kundërta. Këto raste janë zgjidhur nga grupi i punës që funksionon pranë kësaj shkolle, ku bëjnë pjesë zv/drejtori i shkollës, psikologjia, mësuesit kujdestarë. Njëkohësisht, në këtë shkolle funksionon dhe është në zbatim plani i punës kundër dhunës. Pretendimet për dhunë të ushtruar nga mësuesit ndaj nxënësve romë janë përgënjeshtuar nga vetë prindërit e fëmijëve romë.
- Lidhur me pretendimet për vënien e mungesave pa arsye, kur fëmijët romë angazhohen në aktivitete kulturore (të ndërmarra ose jo nga vetë shkolla), që kanë çuar në humbjen e vitit shkollor, rezultoi se i vetmi rast ishte ai i nxënësit Elised Zeqiraj, i cili tashmë ishte kthyer në shkollë dhe ndiqte normalisht procesin mësimor.

Për vitin mësimor 2016-2017, në shkollën 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës nuk kanë kaluar vitin shkollor 18 nxënës, që i përkasin komunitetit rom dhe jo rom. 9 (nëntë) prej tyre janë caktuar për të dhënë provimet në sezonin e vjeshtës, nga të cilët 3 (tre) nuk janë paraqitur në provim dhe si rrjedhim janë përsëritës të vitit shkollor. Kurse 9 (nëntë) nxënësit e tjerë nuk kanë

kaluar vitin shkollor për shkak të mungesave të shumta. Ndër ta ka nxënës romë dhe jo romë. Për këta nxënës, drejtoria e shkollës ka kërkuar nga prindërit e tyre që të sjellin justifikim për mungesat e kryera gjatë vitit shkollor dhe në vijim këta nxënës të merreshin në provim sipas procedurave përkatëse. Duke qënë se prindërit nuk sollën asnjë justifikim për fëmijët e tyre, këta të fundit nuk e kaluan vitin shkollor. Për vitin mësimor 2016-2017, nga 8 nxënës që kanë përsëritur vitin shkollor, 5 janë romë dhe 3 janë jo romë.

- Lidhur me pretendimet për diskriminim dhe neglizhencë të përfshirjes së nxënësve romë në orën e mësimit dhe jashtë saj nga stafi mësimor i shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, për mos përfshirje të prindërve romë në aspekte të ndryshme, lidhur me arsimin e fëmijëve të tyre, si dhe për braktisje të shkollës, pas dhunës së ushtruar ndaj nxënësve romë rezultoi se :

Nxënësit romë që mësojnë pranë shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë nuk trajtohen me neglizhencë nga stafi mësimor i kësaj shkolle. Një shqetësim i ngritur nga drejtuesit dhe stafi mësimor i shkollës është çështja e mos interesimit të prindërve romë mbi mbarëvajtjen në shkollë të fëmijëve të tyre, përjashtuar ata prindër, që i kanë fëmijët në klasë të parë. Edhe kur shkollla organizon takime periodike me prindër, prindërit e nxënësve romë nuk paraqiten fare dhe ky konsiderohet si një shqetësim, me të cilin përballet i gjithë stafi mësimor i kësaj shkolle.

Por, pavarësisht sa më sipër, arritjet e bashkëpunimit ndërmjet stafit mësimor të kësaj shkolle me shoqatat dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare kanë qënë të dukshme edhe në aspekte të tjera, përveç atyre të sipërpërmendura, të tilla si: ndjekja e shkollës së mesme nga nxënësit romë, përfshirja e tyre në organet e shkollës dhe në aktivitete të ndryshme, përfshirja e prindërve të komunitetit rom në Komitetet e prindërve të shkollës dhe klasave.

Numri i nxënësve romë, që kanë braktisur shkollën në 3 (tre) vitet e fundit është, si më poshtë:

- (1) Për vitin shkollor 2014-2015 ka qënë 12 (*dymbëdhjetë*) nxënës;
- (2) për vitin shkollor 2015-2016 ka qënë 8 (*tetë*) nxënës;
- (3) për vitin shkollor 2016-2017 ka qënë 6 (*gjashhtë*) nxënës.

Për sa më sipër, vihet re tendenca në ulje e braktisjes së shkollës nga nxënësit romë që mësojnë pranë kësaj shkolle. Këta nxënës largohen për një periudhë tremujore jashtë shtetit dhe kur rikthehen pranohen në shkollë për të vazhduar në klasën përkatëse. Në rastet kur nuk kthehen brenda vitit dhe nuk kanë ndjekur shkollën në vendet përkatëse, atëherë përsërisin vitin shkollor.

Numri i nxënësve romë që mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë ka patur tendencë rritjeje, falë punës së vazhdueshme të stafit të mësuesve të kësaj shkolle në bashkëpunim me shoqata të ndryshme, që kanë patur si synim afrimin e fëmijëve romë me

institucionin shkollor, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme. Nga 33 nxënës romë që kanë ndjekur shkollën para 8 vitesh, tashmë numri i tyre është rritur në 96 të tillë. Gjatë vitit shkollor 2015-2016 kanë ndjekur shkollën 83 fëmijë të komunitetit rom, gjatë vitit shkollor 2016-2017–87 fëmijë të komunitetit rom dhe gjatë vitit shkollor 2017-2018 ndjekin shkollën 96 nxënës që i përkasin këtij komuniteti. Numri i nxënësve romë që mësojnë nga klasa e parë në klasën e gjashtë pranë kësaj shkolle është i barabartë me numrin e nxënësve jo romë dhe tendenca është për të qënë më i madh se ky i fundit.

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se nxënësit romë të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues, nga ana e stafit mësimor të kësaj shkolle. Në mungesë të ekzistencës së një trajtimi të tillë, nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkak të racës (rome) të nxënësve të këtij komuniteti, që mësojnë pranë këtij institucioni arsimor.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, neni 17, neni 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të races, të nxënësve romë të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, nga ana e drejtuesve dhe stafit mësimor të kësaj shkolle.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankimi, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Irma BARAKU

KOMISIONER

(Shkak: raca
Fusha: arsim)